




Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-201826
Më 22.11.2016



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të nënkryetares së Komunës për Komunitete, kryetari i Komunës, me 22 nëntor 2016, mori këtë:

A K T V E N D I M
Për formimin e Komitetit Komunal Veprues

1. Formohet dhe emërohet Komiteti Komunal Veprues për monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit në nivel lokal, për periudhën 2017-2021. Anëtarë të këtij komiteti emërohen:
 - 1.1. Sabina Dana, nënkryetare për Komunitete, DKRS,
 - 1.2. Shpresa Goçaj, drejtoreshë e DSh,
 - 1.3. Ajradin Alija, shef i ZKK,
 - 1.4. Fatmir Pireci, nga DPMS,
 - 1.5. Reshit Kushaj, nga DASH,
 - 1.6. Mybexhel Zhuri, NJDNJ.
2. Detyrat e Komiteti Komunal Veprues (KKV) janë: përcjellja dhe monitorimi i zbatimit të aktiviteteve në fushat përkatëse të parapara me Strategjinë dhe Planin e Veprimit në nivel lokal, për periudhën 2017-2021, të nxjerrin rekomandime për përmirësim eventual të aktiviteteve dhe t'ia përcjellin informatat relevante ZQM-së.
3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.
4. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: nënkryetarja e Komunës për Komunitete dhe të emëruarit.
5. Ky Aktvendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-201827
Më 22.11.2016



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 të UA nr. 21/2009 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës më 22 nëntor 2016, miratoi këtë:

AKTVENDIM Për formimin e Komisionit

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës për formimin e Komisionit për vlerësimin e pasurive komunale për vitin 2016. Për anëtarë të këtij komisioni, emërohen:
 - 1.1. Alban Susuri, kryetar,
 - 1.2. Fejsal Hoti, dhe
 - 1.3. Shyhrete Kovaq, anëtarë.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit nga pika I e këtij Aktvendimi do të jenë ato që janë paraparë me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 21/2009 për Menaxhimin e Pasurisë Qeveritare.
3. Ky Komision, për punën e bërë do të raportojë me shkrim para organeve kompetente të Komunës së Prizrenit.
4. Puna e komisionit llogaritet si punë jashtë orarit të rregullt të punës dhe se për punën e bërë anëtarët e Komisionit do të kompensohen nga ana e KK-së.
5. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.
6. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës dhe të emëruarit



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-201830
Më 22.11.2016




Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 të UA nr. 21/2009 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës më 22 nëntor 2016, miratoi këtë:

AKTVENDIM Për formimin e Komisionit

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës për formimin e Komisionit për regjistrimin dhe evidentimin e mjeteve themelore-inventarit dhe pajisjeve tjera në të gjitha objektet e Komunës së Prizrenit për vitin 2016. Për anëtarë të këtij Komisioni, emërohen: 1. Naim Kukaj, 2. Sherife Çengaj, 3. Ylber Gashi, 4. Gylaj Gështenja, 5. Sefer Avduti, 6. Hava Berisha, 7. Agim H Rexhepi, 8. Azem Bilibani, 9. Fail Hoxha, 10. Ramadan Tafallari, 11. Forti Skoro, dhe 12. Alifat Karahoda, anëtarë. Komisioni i lartcekur duhet të mbështetet edhe nga Shërbimi i Furnizimit dhe Shërbimi Teknik i KK-së.
2. Komisioni nga pika 1 e këtij Aktvendimi do të bëjë regjistrimin dhe evidentimin e inventarit në këto objekte: Në Objektin e Ekzekutivit të KK-së, në objektin e ndërtesës së Kuvendit të Komunës, në zyrat e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financave, në QPS-së, në Bibliotekën Ndërkomunale, në zyrat e Gjendjes Civile dhe objektet tjera që menaxhohen nga Komuna e Prizrenit.
3. Ky Komision, për punën e bërë do të raportojë me shkrim para organeve kompetente të Komunës së Prizrenit.
4. Puna e komisionit llogaritet si punë jashtë orarit të rregullt të punës dhe se për punën e bërë anëtarët e Komisionit do të kompensohen nga ana e KK-së.
5. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.
6. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës dhe të emëruarit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-201832
Më 22.11.2016

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare, për organizimin e turneut në futboll të vogël në fshatin Piranë, kryetari i Komunës më 22 nëntor 2016, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare, për organizimin e turneut në futboll të vogël që do të mbahet për nder të 28 Nëntorit në fshatin Piranë. Ky turne i kushtohet dëshmorëve Skender Latifi dhe Vahit Ukaj dhe i njëjti organizohet nga Këshilli Organizativ i këtij aktiviteti, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet financiare në shumë prej 300 €.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga Buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe mallrave dhe shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë e Sportit dhe Kryetarit të Komunës.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, KO, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-201835
Më 22.11.2016



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Maqedoni dhe pagesës së mëditjeve për Islam Elshanin, zyrtar komunal, kryetari i Komunës më 22 nëntor 2016, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Islam Elshanit, zyrtar komunal, për në Shkup të Maqedonisë, me qëllim të pjesëmarrjes në modulën e fundit të punëtorisë të organizuar nga GIZ/SoRi, me temën: “Integrimi i minoriteteve”. Punëtorija-trajnimi, do të realizohet nga data 30 nëntor 2016 deri më 1 dhjetor 2016, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurin.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës për Komunitete dhe Kthim.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja